

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                           |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Oligarku Allajbeu përplasët me shtetin për tenderin 18 mln € të Check-up-it                               |
| ADRESA  | <a href="https://joq-albania.com/artikull/1393880.html">https://joq-albania.com/artikull/1393880.html</a> |
| BURIMI  | joq-albania.com                                                                                           |
| GJENDJA | online                                                                                                    |

## KOHA


|                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE     | 24 shtator 2026, 12:35:27 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                                                                                                                                                                                                                                          |
| LEXUAR NGA FAQJA | 24 shtator 2026, 12:29:00 UTC<br><i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën <b>text_date</b>. Dritarja: 24 shtator 2026, 12:28:00 UTC → 24 shtator 2026, 12:30:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 87d05b38588ea0e68fcc0e9bb299390189144fcddafa9d8caa5093f4705c9853 |
| TEKSTI     | 08f45fec7a2f13eddb3814d66a3f167ff4cbb4c464876bb0726714dad86552c8 |
| PAMJA      | b62061145c9bfdec30e7f8dbc14afb4fdeb066da542b523b93ee99190f499547 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 575d1adc8eef3b62d5a6c9f65836fe2185403296360e2cc5ce400742e6562db8                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | ff908387fa0a76615844b1eb2f3b6d25afb991cdfafb8197b5cbb8a7a203d8c9                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/575d1adc8eef3b62d5a6c9f65836fe2185403296360e2cc5ce400742e6562db8>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



## Oligarku Allajbeu përplaslet me shtetin për tenderin 18 mln € të Check-up-it

Shkruar nga: S. H | Publikuar më: 24.09.2026, 14:29



Një tjetër tender milionësh në shëndetësi sjell në skenë emrin e biznesmenit Klodian Allajbeu. Kompania e tij "Evita" ka ankumuar në Komisionin e Prokurimit Publik tenderin për kite, reagentë dhe materiale mjekësore për Check-up-in, me fond rreth 1.6 miliardë lekë, ose afro 18 milionë euro. "Evita" kundërshton kriteret e Lotit 2, duke kërkuar dokumentacion më të plotë për prodhuesit, autorizimet, katalogët teknikë dhe specialistët e certifikuar. Pra, gara për 18 milionë euro nis jo me ofertat, por me debatin se cilat duhet të jenë rregullat e garës.


Procedura vjen pas tenderit të hemodializës, ku "Diaverum AB" ishte shpallur fituese si ofertuesja e vetme, me një ofertë sa rreth 97% e fondit limit prej 4.5 miliardë lekësh. Në atë kohë u ngritën pikëpyetje për konkurrencën dhe u rikthyen në vëmendje lidhjet e mëparshme të "Diaverum", DiaVita-s dhe Spitalit Amerikan të Allajbeut. Ndërkohë, Arisa Cane, e cila kishte punuar më herët në Spitalin Amerikan, është larguar nga drejtimi i Operatorit të Shërbimeve të Integruara Shëndetësore dhe është zëvendësuar nga Yllka Kukalaj.

"Evita" e lidhur me Klodian Allajbeun hyn në betejën për një tender të majmë në shëndetësi. Tenderi i Check-up-it është ndarë në pesë lote, ndërsa për katër prej tyre është shkurtuar afati i ofertimit, në një kohë kur rezervat e kiteve janë të kufizuara. Kjo ngre pikëpyetjen e natyrshme: si ka mundësi që një nevojë e parashikueshme, pas kalimit të Check-up-it nën administrimin shtetëror, përfundon me nxitim dhe ankim në KPP? Për momentin "Evita" nuk është fituese dhe kontrata nuk është lidhur; ajo po kërkon ndryshimin e rregullave të tenderit. Pas hemodializës, topi është sërish në fushën e KPP-së, ndërsa 18 milionë eurot presin të vendosin se kush do t'i marrë.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).

JOQ Sondazh  
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME



Më të Lexuarat



ARTIKULL JOETIK?

## Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

[Puno me ne!](#)

[Marketing](#)

[Politika e privatësisë](#)

[Rreth Nesh](#)

[Kushtet e përdorimit](#)

[Kontakt](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.